

Nr. 14 Janar 2020

I. Pritshmëritë në arritjen e rezultateve konkrete në kuftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar pas ngritjes së Prokurorisë dhe Gjykatave të Posaçme

Me emërimin e 8 prokurorëve dhe zgjedhjen e Drejtuesit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) në dhjetor 2019, Prokuroria e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ka filluar tashmë zyrtarisht veprimtarinë dhe funksionimin. KLP ka miratuar gjithashtu [Rregullat e Transferimit të Personelit Administrativ të Prokurorisë të Krimeve të Rënda](#) dhe kërkesën e Drejtuesit të SPAK për [transferimin e përkohshëm](#) të 2 prokurorëve duke e çuar numrin e tyre në 10. Numri i prokurorëve të posaçëm do të vazhdojë të jetë një [kërkesë e rëndësishme](#), duke ndikuar edhe në plotësimin e departamenteve të vetë institucionit.

Prokuroria e Posaçme ka përgatitur faqen zyrtare (www.spak.al), e cila do të përditësohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së organit të hetimit dhe e cila ka të përfshirë edhe një rubrikë për raportimin e rasteve të korrupsionit.

Ndërkohë në datën 23 dhjetor 2019 është rregjistruar edhe [padia e parë](#) pas ngritjes së këtij institucioni. Nisma Thurje i ka drejtuar Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar kallëzim penal për zytarët publik të përfshirë në konçesionin e sterilizimit të pajisjeve kirurgjikale, të cilët mund të kenë konsumuar veprat e parashikuara në Kodin Penal për shpërdorimin e detyrës, shkeljen e barazinë së pjesëmarrjes në tendera dhe/ose korrupsionin pasiv duke përdorur pushtetin publik për përfitime private. Prokuroria e Posaçme ka filluar ndërkohë hetimin duke [identifikuar edhe personat](#) e parë, të cilët do të pyeten mbi kallëzimin e depozituar.


Krijimi i Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK) përbën realizmin jo vetëm të një prej qëllimeve kryesore të reformës në sistemin e drejtësisë, por në të njëjtën kohë

SPAK Info Nr. 14 përshkruan disa nga masat e para paraprake të ndërmarra pas fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Për shumë informacion mbi zbatimin në kohë të hapave ligjorë në drejtim të ngritjes së Gjykatave të Posaçme dhe SPAK mund të lexoni Buletinet 3-mujore SPAK Monitor të publikuara në faqen e CSDG: www.csdgalbania.org

Publikimet realizohen në kuadër të projektit “Monitorimi dhe vlerësimi i procesit të ngritjes dhe funksionimit të Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Strukturës së Posaçme SPAK, nëpërmjet hulumtimit, informimit, ndërgjegjësimit dhe mbështetjes në ngritjen e kapaciteteve administrative”, i mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

pritet të justifikojë edhe besimin e qytetarëve ndaj arritjes së rezultate konkrete të organeve të reja të krijuara rishtazi.



* Burimi: Grafik Nr. 47, "Barometri Shqiptar i Sigurisë 2019", Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes

Në përgjigje të pyetjeve drejtuar gjatë realizimit të Barometrit Shqiptar të Sigurisë, 43.05% e qytetarëve të pyetur janë shprehur se me ngritjen e SPAK lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të forcohet shumë, duke theksuar në këtë mënyrë besimin ndaj këtyre institucioneve në drejtim të përmbushjes së objektivave në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

II. Fillimi i procedurave për krijimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), hap i rëndësishëm për plotësimin e strukturës së SPAK

Në faqen zyrtare të Byrosë Kombëtare të Hetimit është publikuar në 10 janar 2020 [thirrja për Drejtor të BKH](#), e cila përbën një nga fazat më të rëndësishme në funksion të plotësimit të strukturës së SPAK. Afati i aplikimit përfundon në datën **30 janar 2019**, ndërkohë që njoftimi parashikon kriteret, kushtet ligjore dhe fazat e përgjedhjes. Ashtu sikurse parashikohet edhe në [legjislacionin përkatës](#), **kushtet ligjore** për kandidatët Drejtor të BKH-së përfshijnë plotësimin e disa kriterëve, të tilla si:

- Kandidati duhet të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë të barazvlefshme me “Master i shkencave”, ose arsimin e lartë policor;
- Kandidati duhet të ketë eksperiencë pune si prokuror, punonjës i Policisë së Shtetit apo i Policisë Gjyqësore, ose Hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit;
- Kandidati duhet të ketë të paktën 5 vjet përvojë pune në çështje që kanë të bëjnë me veprat penale në fushën e korrupsionit, krimit të organizuar apo krimeve të rënda;
- Në rastet e punonjësve aktualë apo të mëparshëm të Policisë së Shtetit, kandidati duhet të ketë mbajtur për jo më pak se 3 vjet gradën “Komisar”, “Kryekomisar”, “Drejtues” apo “Drejtues i Parë”;
- Kandidati nuk duhet të jenë në hetim apo gjykim për një vepër penale dhe në kushtet e pazgjedhshmërisë në një funksion publik sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- Kandidati nuk duhet të ketë mbajtur pozicione politike në administratën publike ose funksione të tjera drejtuese në partitë politike të paktën gjatë dhjetë viteve të fundit përpara momentit të kandidimit;
- Kandidati duhet të kenë marrë vlerësim maksimal për aftësitë profesionale, etike dhe integritetin moral, nëse i është nënshtruar vlerësimeve të mëparshme, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ndaj kandidatit nuk duhet të jetë marrë asnjë masë disiplinore “shkarkim nga detyra” ose masa të tjera të marra kundër tij/saj, të cilat janë ende në fuqi sipas legjislacionit në momentin e kandidimit;
- Kandidati nuk duhet të kenë qenë dhe duhet të mos jetë bashkëpunëtor, informator apo agent i ndonjë shërbimi inteligjent;
- Kandidati, për periudhën 29.11.1944 – 07.02.1991 nuk duhet të kenë qenë anëtar apo kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, punonjës i organeve të ish-Sigurimit të Shetit, bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit apo i favorizuar, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim – Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese politike, denoncues apo dëshmitar i akuzës në procese politike të posaçme;
- Kandidati dhe anëtarët e afërt të familjes së tij/saj duhet të plotësojnë dhe nënshkruajnë deklaratat për heqjen dorë nga privatësia, në mënyrë që nëse ai/ajo emërohet, komunikimet elektronike dhe llogaritë bankare të kandidatit dhe familjarëve të tij të jenë subjekt i monitorimit sipas përcaktimeve të neneve 3 dhe 6 të Ligjit Nr. 95/2016;
- Kandidati do t'i nënshtrohen një procesi rigoroz trajnimi dhe do të emërohet si Drejtor i BKH-së vetëm pas përfundimit me sukses të të gjitha aspekteve të programit të trajnimit.

Sa i përket **fazës së dytë të aplikimit**, nëse kandidatët vlerësohen si kandidatë të mundshëm, aplikantët do t'i nënshtrohen procesit të përzgjedhjes dhe testeve respektive të përzgjedhjes, sipas hapave të parashikuar edhe në [legjislacion](#):

- Testim i aftësive fizike që mat forcën dhe rezistencën fizike (para këtij testimi fizik kandidati duhet të ketë me vete një Raport Mjekësor për Aftësisë Fizike të lëshuar nga specialisti kardiolog);
- Provim me shkrim e me gojë që përfshin teste konjitive të sjelljes dhe të arsyetuarit logjik;
- Një provim të zgjeruar me shkrim që mat aftësitë e shkrimit të raporteve, si edhe nivelin e shkrimit dhe të leximit;
- Intervistë nga Komisioni i Përzgjedhjes në Prokurorinë e Posaçme që mat aftësitë e komunikimit verbal, si dhe aftësinë e aplikantit për të komunikuar idetë me efikasitet;
- Një vlerësim i plotë mjekësor që vërteton që aplikantët plotësojnë standartet e duhura shëndetësore për të përmbushur nevojat e punës;
- Në një fazë të mëvonshme, kandidati i nënshtrohet procesit të verifikimit nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, si edhe testit të poligrafit.

Testet e Përzgjedhjes	
Kategoria e Testit	Përshkrimi
1. Testi i aftësisë fizike	Test i aftësive fizike që përfshin testim në palosje, sprint 300 m, pompa dhe vrapim 2.4 km.
2. Arsyetimi logjik	Test që mat aftësitë e kandidatit në lidhje me të menduarin kritik, ku përfshihet përpunimi i fakteve, nxjerrja e përfundimeve dhe arsyetimi abstrakt.
3. Shkruajtja e eseve	Test që mat aftësitë e kandidatit për të shprehur ide me shkrim dhe saktësinë ortografike, gramatike, formatin, prezantimin dhe sa i është përmbajtur kandidati pyetjes.
4. Intervista e strukturuar	Test që mat aftësinë e kandidatit për të shprehur verbalisht ide, për të shprehur vlerat e tij/saj profesionale dhe për të dhënë zgjidhje për probleme që kanë lidhje me punën.

* Burimi: Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH): (<https://bkh.al/wp-content/uploads/2020/01/Testet-e-perzgjedhjes.pdf>)


Në të njëjtën kohë, kandidatët për pozicionin e Drejtorit të BKH-së duhet të plotësojnë dhe nënshkruajnë [formularin e aplikimit](#) së bashku me [Deklaratat Nr. 2 dhe 3, Shtojca B](#), për Heqjen Dorë nga Privatësia, për veten dhe familjarët e afërt. Drejtori i BKH-së do ti propozohet KLP-së nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme së bashku me dy prokurorë të posaçëm. Gjatë periudhës në vijim do të publikohen edhe lajmërimet për vendet e punës për 60 hetues të BKH.

III. Numri i ulët i gjyqtarëve dhe statusi i tyre i rivlerësimit, faktor pengues në funksionimin e Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar kanë zhvilluar gjithashtu seancën e parë në 23 dhjetor 2019 (Gjykata e Posaçme e Apelit) që nga krijimi si të tilla në [19 dhjetor 2019](#). Megjithatë, numri i gjyqtarëve të [emëruar](#) nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) në këto gjykata (12 në shkallën e parë dhe 6 në apel), jashtë parashikimeve ligjore (16 në shkallën e parë dhe 11 në apel) dhe statusi i tyre i rivlerësimit mbeten problematike për funksionimin normal të tyre.

Numri i gjyqtarëve të konfirmuar në detyrë nga institucionet e rivlerësimit ka krijuar probleme që në [mbarvajtjen e seancave të para](#) të Gjykatave të Posaçme, duke risjellë shtyrje të tyre pasi anëtarët e trupi gjyqësor janë të deleguar dhe nuk gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme, fakt i cili ka sjellë nevojën për [ndërhyrjen e KLGJ-së](#) në zgjidhjen e këtij bllokimi.

Me konfirmimin në detyrë në të dyja shkallët, gjyqtarët e Gjykatave të Posaçme KKKO mund të emërohen në mënyrë të përhershme në këto institucione dhe ky proces është thelbësor edhe në drejtim të plotësimit të vendeve vakante në këto organe.



* Burimi: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) (www.kpk.al)

I. Statusi i vetting-ut për gjyqtarët e Gjykatave të Posaçme KKKO

Statusi i vetting-ut për gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë KKKO					
		Seanca Dëgjimore	Vendimi i KPK	Vendimi i IKP	Vendimi i KPA
1.	Sandër Simoni	14.01.2020	Konfirmuar në detyrë		
2.	Ardit Mustafaj		Në proces rivlerësimi		
3.	Irena Gjoka		Në proces rivlerësimi		
4.	Daniela Shirka	07.11.2019	Konfirmuar në detyrë		
5.	Etleva Deda		Në proces rivlerësimi		
6.	Flora Hajredinaj		Në proces rivlerësimi		
7.	Fran Prendi		Në proces rivlerësimi		
8.	Ilirjana Olldashi	02.12.2019	Konfirmuar në detyrë		
9.	Marsela Balili	13.01.2020	Shkarkuar nga detyra		
10.	Bib Ndreca		Në proces rivlerësimi		
11.	Miliana Muça		Në proces rivlerësimi		
12.	Klodian Kurushi	05.12.2019	Konfirmuar në detyrë		
Statusi i vetting-ut për gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit KKKO					
1.	Nertina Kosova	17.07.2018	Konfirmuar në detyrë	Vendimi i KPK ankimuar në KPA	Konfirmuar nga KPA
2.	Nure Dreni		Në proces rivlerësimi		
3.	Saida Dollani	20.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
4.	Dhimitër Lara	27.05.2019	Konfirmuar në detyrë		
5.	Sokol Binaj	17.05.2019	Konfirmuar në detyrë		
6.	Albana Boksi	04.04.2019	Konfirmuar në detyrë		

* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 20 janar 2020

2. Statusi i vetting-ut për 14 kandidatët të cilët u renditën për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Statusi i vetting-ut për 15 kandidatët e renditur për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar					
		Seanca Dëgjimore	Vendimi i KPK	Vendimi i IKP	Vendimi i KPA
1.	Altin Dumani	30.07.2019	Konfirmuar në detyrë		
2.	Anton Martini	10.12.2019	Nuk është caktuar data e dhënies së vendimit		
3.	Elizabeta Imeraj		Në proces rivlerësimi		
4.	Arben Kraja	13.12.2018	Konfirmuar në detyrë		
5.	Doloreza Musabelliu	02.12.2019	Konfirmuar në detyrë		
6.	Klodjan Braho	25.07.2019	Konfirmuar në detyrë		
7.	Enkeleda Millonai	13.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
8.	Manjola Kajana	18.06.2019	Konfirmuar në detyrë	Vendimi i KPK ankimuar në KPA	Në proces
9.	Edvin Kondili	06.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
10.	Ened Nakuçi	06.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
11.	Elida Kaçkini	16.07.2019	Konfirmuar në detyrë		
12.	Ndini Tavani	07.10.2019	Shkarkuar nga KPK		
13.	Behar Dibra	20.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
14.	Anita Jella	04.10.2019	Konfirmuar në detyrë		

* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 20 janar 2020